



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 14.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Urban Plus" për aktivitetin :"**Konkurs projektimi për Hartim të projektit arkitektonik Qendra e Mjekesise Familjare ne lagjen Prishtina e Re-Zona Perendim**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-953-223 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "Urban Plus" e datës 14.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Konkurs projektimi për Hartim të projektit arkitektonik Qendra e Mjekesise Familjare ne lagjen Prishtina e Re-Zona Perendim**", me Nr.616 19 953 223, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së dhe Rezultate e vleresimit teknik të konkursit ,të dates 08.05.2019,te publikuar ne E Prokurim;
2. Vërtetohet Vendimi për rezultatet e vleresimit artistik i publikuar me datë: 08.05.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Opratori Ekonomik "Urban Plus" me datë 14.05.2019 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"' **Konkurs projektimi për Hartim të projektit arkitektonik Qendra e Mjekesise Familjare ne lagjen Prishtina e Re-Zona Perendim**".

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me rezultatet e vleresimit artistik,por ka dorezuar kerkesen e tij pas afatit te parapare ligjor dhe

arsyetimi i tij per dergimin e ankeses gabimisht ne OSHP nuk eshte i qendrueshem, pasiqe rregullat lidhur me parashtrimi e ankesave jane te qarta dhe sipas tyre kerkesa duhet te dergohet se pari ne Autoritetin Kontraktues.

Bazuar në faktin se Autoriteti Kontraktues ka pranuar kerkesen per rishqyrtim pas afatit te parapare ligjor, konstaton se e njejta është e pa bazuar.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit